

URDHËR

Nr. 61, Datë 26/08/2014


**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "NDALOHET PIRJA E DUHANIT" NË AMBJENTET
E PUNËS DHE STUDIMIT NË UNIVERSITETIN E ARTEVE**


Në bazë të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë",
i ndryshuar, nenit 15, pika 2, të ligjit nr. 9636, datë 06.11.2006, të ndryshuar, "Për
mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", të nenit 39, të Statutit të Universitetit të
Arteve,


URDHËROJ:

1. Miratimin e Rregullore "NDALOHET PIRJA E DUHANIT" në ambientet e punës dhe
studimit në Universitetin e Arteve.
2. Ngarkohen të gjithë punonjësit dhe studentët në UART për zbatimin e kësaj
rregulloreje.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.


Prof. Petrit MALAJ
REKTOR
UNIVERSITETI I ARTEVE





REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI

Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel/Fax: +355 42 225 488, www.uart.edu.al

RREGULLORE


" NDALOHET PIRJA E DUHANIT "

NË AMBJENTET E PUNËS DHE STUDIMIT

NË

UNIVERSITETIN E ARTEVE





Neni 1

Ligjeshmëria e Rregullores

Rregullorja "**NDALOHET PIRJA E DUHANIT**", në ambientet e punës dhe studimit në UART, hartohet në zbatim të nenit 15, pika 2, të ligjit nr. 9636, datë 06.11.2006, të ndryshuar, "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit".

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore është mbrojtja e shëndetit të punonjësve dhe studentëve në UART, nga përdorimi i produkteve të duhanit dhe ekspozimi i pavullnetshëm ndaj tymit të tyre.

Neni 3

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i masave për kufizimin e përdorimit të produkteve të duhanit dhe mbrojtjen e punonjësve dhe studentëve nga ekspozimi i pavullnetshëm ndaj tymit të tyre, ndërgjegjësimit të tyre për dëmet nga pirja e duhanit dhe informimin për të parandaluar fillimin e pirjes së duhanit.

Neni 4


Administratorët përgjegjës kryesor në UART

Në kuptim të ligjit nr. 9636, datë 06.11.2006, të ndryshuar, "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", të ndryshuar, Kancelarja dhe Dekanët e Fakulteteve, në UART, janë "**Administratorët Përgjegjës Kryesor**", që ngarkohen në ndjekjen dhe zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj.

Neni 5

Administratorët përgjegjës

Në kuptim të ligjit nr. 9636, datë 06.11.2006, të ndryshuar, "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit, të ndryshuar, Kryetarët e Degëve në Fakultete, Përgjegjësat e Departamenteve, Drejtori i Drejtorisë Ekonomike, Drejtorja e Bibliotekës, Kryetarët e Degëve në UART, etj. të marrin masa për ndalimin e pirjes së duhanit në ambientet e punës dhe studimit, nga punonjësit dhe studentët.





Neni 6

Publikimi i Masve parandaluese në faqen zyrtare të internetit të UART

Dega e IT, në UART, në faqen zyrtare të UART, të publikojë mesazhe informuese për ndikimin e duhanpirjes në shëndetin dhe rreziqet nga produktet e duhanit, për punonjësit dhe studentët e Universitetit të Arteve.

Neni 7

Tabela "NDALOHET PIRJA E DUHANIT".

Administratorët përgjegjës kryesor në UART, në bashkëpunim me njëri tjetrin të marin masa që në çdo mjedis të dukshëm (ambiente pune, salla mësimi, korridore, etj.) të vendosen tabela të dukshme dhe të lexueshme, " **NDALOHET PIRJA E DUHANIT**".

Neni 8

Masa parandaluese në ambientet e punës dhe studimit


Kancelarja e UART, në bashkëpunim me Dekanët e Fakulteteve në UART, të marin masa parandaluese të duhanpirjes, në mjediset e punës, si zyra, salla mbledhjes, korridore, shkallë, salla leksionesh, dhoma tualeti, dhe çdo mjedis tjetër i mbyllur, që frekuentohet gjatë orarit të punës dhe mësimi.

Neni 9

Informacion për trupat inspektuese

Kancelarja e UART dhe Dekanët e Fakulteteve, në kuptim të ligjit nr. 9636, datë 06.11.2006, të ndryshuar, "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", si **administratorët përgjegjës kryesor**, për ndalimin e pirjes së duhanit në ambientet e UART, të vendosin në një vend të dukshëm listën e trupave inspektuese për mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe të studentëve, nga produktet e duhanit, dhe të shenjave të dukshme, që tregojnë se pirja e duhanit në këto mjedise është e ndaluar.





Neni 10

Institucioni përgjegjës për kontrollin e zbatimit të ligjit antiduhan
Institucioni përgjegjës për kontrollin e zbatimit të ligjit nr. 9636, datë 06.11.2006, të ndryshuar, "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", për UART është Inspektorati që mbulon fushën e Arsimit.

Neni 11

Bashkëpunime me subjektet private që shërbejnë në ambientet e UART
Kancelarja e UART, me autoritetin e përgjegjësitet në UART, të bashkëpunojë me Administratorin e shoqërisë "CORNER", shpk dhe Administratorin e shoqërisë që ka me qera " Bodrumin e nëndheshëm", që në këto njësi shërbimi të zbatohet me korektësi ligjit nr. 9636, datë 06.11.2006, të ndryshuar, "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit".

Neni 12

Kundërvajtjet Administrative

Shkeljet e nenit 15, të ligjit nr. 9636, datë 06.11.2006, të ndryshuar, "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

- a) Personi përgjegjës kryesor dhe përgjegjësat e zyrave, sipas nenit 4 dhe 5, të kësaj rregulloreje, gjobiten 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;
- b) Duhanpirësi, gjobitet me 5 000 (pesë mijë) lekë;
- c) Administratori i Shoqërive, gjobitet me 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

Neni 13

Të ardhurat nga gjobat e vendosura, derdhen në Buxhetin e Shtetit.

